
Instituti i Kërkimeve Urbane

Dokument i Qeverisjes

Kodi i Vlerave dhe Etikës



PËRMBAJTJA

1. VLERAT DHE STANDARDET ETIKE	2
2. FUSHA E ZBATIMIT DHE QËLLIMI	2
3. INTEGRITETI NDËRMJET KOLEGËVE	2
4. INTEGRITETI NË BIZNES.....	4
5. INTEGRITETI NË KOMUNITET.....	6
6. ZBATIMI I KODIT TË VLERAVE DHE ETIKËS	9

1. VLERAT DHE STANDARDET ETIKE

Organizata identifikohet kryesisht me vlerat dhe standardet etike të mëposhtme:

- Integriteti: Jemi transparentë dhe të ndershëm në komunikimet dhe veprimet tona dhe punojmë vazhdimisht për të promovuar këto vlera.
- Përsosmëria: Kapërcejmë sfidat duke punuar së bashku për të gjetur zgjidhjet më të mira dhe për të rritur performancën.
- Respekti: Vlerësojmë diversitetin kulturor, gjinor, moshor dhe individual dhe e trajtojmë çdo person me mendje të hapur dhe mirësjellje.
- Përgjegjësia: Jemi plotësisht të përkushtuar për të arritur standardet dhe masat e sigurisë në punën tonë, komunitetet dhe shoqërinë.
- Përkushtimi: Jemi të përkushtuar ndaj punës dhe kauzës sonë dhe i përdorim këto vlera për të mbetur të motivuar dhe për t'iu përshtatur ndryshimeve.

2. FUSHA E ZBATIMIT DHE QËLLIMI

Ky Kod i Vlerave dhe Etikës përcakton vlerat dhe standardet etike të URI-t, në përputhje me kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë dhe me standardet ndërkombëtare.

Ky Kod i Vlerave dhe Etikës zbatohet për të gjitha palët, persona fizikë ose juridikë, që janë të përfshirë dhe të angazhuar me veprimtarinë e organizatës: punonjësit, drejtuesit, anëtarët e organeve drejtuese, kontraktorët, nënkontraktorët ose partnerët e saj; përgjatë këtij Kodi të Vlerave dhe Etikës, termi “Ne” u referohet të gjitha palëve.

Palët e treta duhet të respektojnë parimet e parashikuara nga Kodi i Vlerave dhe Etikës i URI-t dhe çdo dispozitë tjetër kontraktore. URI mund të mbahet përgjegjës për të gjitha veprimet e palëve të treta që ofrojnë shërbimet e tyre në emër të URI-t.

3. INTEGRITETI NDËRMJET KOLEGËVE

Punonjësit e URI-t veprojnë në çdo kohë në përputhje me vlerat dhe etikën e këtij Kodi gjatë kryerjes së punës së tyre, ndjekin të gjitha trajnimet dhe mbahen të përditësuar me standardet e organizatës.

3.1 Respektimi i të Drejtave të Njeriut

URI vepron në përputhje të plotë me kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë, përfshirë të gjithë legjislacionin e zbatueshëm të punës dhe punësimit, si dhe konventat përkatëse ndërkombëtare të punës. URI është i përkushtuar të mbështesë parimet e parashtruara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Në përputhje me këtë angazhim, URI siguron që të gjithë punonjësit të trajtohen me drejtësi, respekt dhe dinjitet, dhe që të drejtat e tyre të mbrohen në çdo kohë.

3.2 Promovimi i Mundësive të Barabarta dhe Diversitetit

URI merr vendime që promovojnë mundësi të barabarta dhe diversitet, pavarësisht nga gjinia, besimi fetar, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar fizike, orientimi seksual, statusi familjar, bindjet politike ose karakteristika të tjera të mbrojtura nga ligji.

3.3. Mosdiskriminimi, Shfrytëzimi Seksual, Abuzimi dhe Ngacmimi Seksual

URI është i përkushtuar të krijojë dhe mbajë një mjedis pune të lirë nga çdo formë diskriminimi dhe ngacmimi. Organizata zbaton një qasje të tolerancës zero ndaj diskriminimit ose ngacmimit në bazë të gjinisë, besimit fetar, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar fizike, orientimit seksual, statusit familjar, bindjeve politike ose çdo karakteristike tjetër të mbrojtur nga legjislati i zbatueshëm.

Ky parim zbatohet për të gjithë individët e angazhuar në veprimtaritë e URI-t, përfshirë punonjësit, kontraktorët, nënkontraktorët, konsulentët dhe çdo palë të tretë që vepron në emër të URI-t. Të gjitha këto palë duhet të respektojnë Kodin e Vlerave dhe Etikës të URI-t si kusht angazhimi.

URI siguron që kjo qasje e tolerancës zero të zbatohet efektivisht në praktikë përmes rregullave të brendshme, procedurave dhe mekanizmave të raportimit të shkeljeve. Çdo shkelje e këtyre parimeve do të trajtohet në përputhje me politikën e URI-t, detyrimet kontraktore dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm.

3.4. Sigurimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Vendin e Punës

Suksesi i URI-t varet nga krijimi i një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë punonjësit dhe ata që preken nga veprimtaria jonë. Për të parandaluar aksidentet në punë, punonjësit duhet të:

- Zhvillojnë një kulturë që promovon një qasje të përgjegjshme ndaj shëndetit dhe sigurisë.
- Sigurojnë që aspektet e shëndetit dhe sigurisë të jenë të integruara në veprimtari dhe që punonjësit të kenë marrë trajnimin e duhur.
- Njohin procedurat e URI-t për shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Veprojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe të mos vënë në rrezik sigurinë e të tjerëve.
- Ndërmarrin të gjitha masat parandaluese gjatë përdorimit të pajisjeve ose makinerive me ngarkesë të rëndë;
- Raportojnë aksidentet.
- Sjellin në vëmendje të drejtuesve rreziqet e mundshme që rrjedhin nga mosrespektimi i rregullave dhe standardeve.
- Njohin veprimet që duhen ndërmarë gjatë situatave emergjente.

Përveç kësaj, gjatë kryerjes së veprimtarive në emër të URI-t, punonjësit nuk duhet të jenë nën ndikimin e drogës, pijeve alkoolike dhe substancave të tjera që cenojnë sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e punës. Ky rregull nuk zbatohet plotësisht në evenimentet e veçanta të organizuara nga URI ku lejohet konsumi i moderuar i pijeve alkoolike.

3.5 Respektimi i Privatësisë

URI është i përkushtuar ndaj respektimit të privatësisë së të dhënave personale. Prandaj, punonjësit

- Mbledhin, regjistrojnë dhe përpunojnë vetëm të dhënat personale të nevojshme që URI të zhvillojë veprimtarinë e tij në përputhje me Vlerat dhe Etikën. Të gjitha të dhënat personale do të trajtohen në përputhje me ligjin;
- Përpunojnë të dhënat vetëm në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe politikat e mbrojtjes së të dhënave të URI-t;
- Janë të vetëdijshëm, të hapur dhe transparentë për llojin e të dhënave personale që mbledhin dhe qëllimin e përdorimit të tyre;
- Nuk u zbulojnë të dhëna personale palëve të treta, përveç rasteve kur procedurat janë në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe politikat e URI-t.

4. INTEGRITETI NË BIZNES

4.1. Mbrojtja përmes Prokurimit Etik

URI është i rëndësishëm për vendet dhe rajonet ku zhvillon veprimtarinë e tij. Kompani dhe operatorë të tjerë biznesi janë të interesuar të nënshkruajnë kontrata biznesi me URI-n. Është thelbësore që URI të ruajë një qëndrim neutral ndaj presioneve të jashtme. Të gjitha mallrat dhe shërbimet ofrohen nga furnitori që ofron çmimin, cilësinë dhe nivelin më të mirë të shërbimit. Furnitorët përzgjidhen përmes një procesi tenderimi transparent, jodiskriminues dhe konkurrues për të gjitha mallrat dhe shërbimet. Kriteret e tenderimit bëhen të disponueshme dhe publike. URI kryen procesin e verifikimit për të gjithë furnitorët që përfshihen në veprimtari me rrezik të lartë për të siguruar që ata mishërojnë vlera të forta etike.

Më tej, URI siguron që do të:

- Nuk angazhohet në detyrime kontraktore përtej kompetencave të tij.
- Sigurojë që do të ketë një ndarje të qartë të detyrave në proceset e tenderimit.
- Nënshkruajë kontrata me shkrim me partnerët tanë të biznesit. Kontrata me shkrim do të detajojë marrëdhëniet e duhura mes URI-t dhe partnerit të tij të biznesit.
- Sigurojë që niveli i pagesës të justifikojë shërbimet e ofruara.
- Bashkëpunojë vetëm me ata partnerë biznesi që mishërojnë kërkesat e URI-t për integritetin;
- Kërkojë që furnitorët të ofrojnë kualifikime teknike dhe standarde etike në nivelin e URI-t.

4.2 Saktësia e Informacionit të Biznesit dhe Të Dhënave Financiare

Të dhënat financiare dhe informacioni i biznesit janë thelbësore për suksesin e URI't. Integriteti dhe saktësia e këtyre të dhënave i raportohen investitorëve, kreditorëve, agjencive shtetërore

dhe partnerëve të tjerë të biznesit. Të dhënat financiare dhe informacioni i biznesit duhet të jenë transparente, të plota dhe në përputhje me rregulloret dhe ligjet e zbatueshme.

Për ta siguruar këtë, URI do të:

- Mbajë një sistem të shëndoshë dhe efektiv të kontrollit të brendshëm për t'u siguruar donatorëve dhe partnerëve të URI-t se paratë e tyre përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme.
- Sigurojë që të gjitha transaksionet e biznesit të regjistrohen dhe të dokumentohen plotësisht dhe me saktësi në regjistrat kontabël të URI-t në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e zbatueshme të kontabilitetit.
- Sigurojë që ruajtja e dokumentacionit të kryhet në përputhje me udhëzimet për ruajtjen e sigurt të dokumenteve. Asnjë dokument nuk mund të shkatërrohet ose copëtohet përpara një procesi auditimi ose hetimi. Punonjësit duhet të kontaktojnë Departamentin e Pajtueshmërisë nëse kanë shqetësime për trajtimin e ndonjë të dhëne specifike.

4.3 Mirëmbajtja e Aseteve të URI-t

URI u ka dhënë besim punonjësve për përdorimin e asetëve dhe ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre dhe përdorimin me kujdes. Asetet e URI-t përfshijnë kohën, fondet, pajisjet e IT-së, materialet, ambientet, informacionin, dokumentet, shënimet, kopjet dhe informacione të llojeve të ndryshme të përdorura nga punonjësit ose që lidhen me punonjësit dhe detyrat e tyre gjatë gjithë periudhës së punësimit.

Për të mirëmbajtur sa më mirë asetet e URI-t, punonjësit do të:

- Sigurojnë që asetet e URI-t të mos humbasin, dëmtohen ose keqpërdoren jashtë çdo kriteri.
- Sigurojnë që asetet e URI-t të mos përdoren për të mbështetur një biznes të jashtëm ose një veprimtari të paautorizuar.
- Dekurajojnë përdorimin e asetëve të URI-t për qëllime personale, megjithëse pranohet në një nivel minimal dhe pa ndikim në performancën dhe mjedisin e punës.
- Nuk i ndajnë fjalëkalimet me të tjerë dhe nuk do të lejojnë persona të tjerë, përfshirë miqtë dhe anëtarët e familjes, të përdorin burimet dhe asetet e URI-t;
- Informojnë menjëherë drejtuesin e tyre ose Departamentin e Pajtueshmërisë nëse kanë dyshime ose shqetësime për vjedhje ose akte mashtrimi të mundshme.

4.4 Komunikimi me Palët e Tjera

Vetëm punonjësit e autorizuar duhet të zbulojnë ose të japin informacion palëve të interesuara. Është e domosdoshme që vetëm punonjësit e autorizuar të flasin në emër të URI-t.

Për ta siguruar këtë:

- Komunikimi me palët e interesuara duhet të jetë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

- Punonjësit nuk duhet të bëjnë deklarata publike për veprimtarinë e biznesit të URI-t, përveç rasteve kur janë të autorizuar për këtë.
- Punonjësit duhet të sigurojnë që dokumentet të shqyrtohen dhe miratohen nga partnerët (drejtuesit) e URI-t përpara se të bëhen publike.

4.5 Ruajtja e Integritetit të Tregut

URI është i përkushtuar të veprojë me integritet dhe në mënyrë të drejtë gjatë konkurrencës me të tjerët. Veprimet dhe sjelljet që cenojnë konkurrencën e ndershme janë të ndaluara. URI do të veprojë në treg duke zbatuar standardet më të larta etike në konkurrencën me kompanitë e tjera brenda hapësirës ligjore të ligjeve mbi konkurrencën dhe antimonopolit që zbatohen edhe për URI-n.

URI nuk do të:

- Bëjë marrëveshje për ndarjen e tregjeve, zonave ose konsumatorëve.
- Bëjë marrëveshje për mos konkurrencë.
- Diskutojë procese që lidhen me pjesëmarrjen në tendera.
- Shkëmbejë informacion mbi çmimet, pjesët e tregut ose kushtet e tjera të tregut me konkurrentët, klientët ose palët e treta në kundërshtim me ligjet ekzistuese.;
- Asistojë kompanitë rivale që ato të mund të koordinojnë veprimet e tyre në kurriz të ligjeve të konkurrencës.

Përveç kësaj, të gjitha informacionet për konkurrentët duhet të mblidhen publikisht, në mënyrë etike dhe ligjore.

5. INTEGRITETI NË KOMUNITET

URI synon të promovojë zhvillimin ekonomik dhe kulturor të komuniteteve në të cilat vepron. Organizata synon ta arrijë këtë objektiv përmes zbatimit të ndërhyrjeve të përgjegjshme nga ana shoqërore dhe të qëndrueshme.

Brenda këtij kuadri, URI është i përkushtuar të shmangë, minimizojë dhe, kur është e nevojshme, të zbusë dhe kompensojë çdo ndikim të mundshëm negativ që rrjedh nga veprimtaritë e tij.

Për ta mbështetur këtë angazhim, URI punon ngushtë me palët e interesit dhe partnerët e tij për të zbatuar praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe për të siguruar që ndërhyrjet e tij të kontribuojnë pozitivisht në komunitetet vendore.

5.1 Shmangia e Korrupsionit

Korrupsioni pengon zhvillimin ekonomik dhe shkatërron konkurrencën e lirë në biznes. Korrupsioni gjithashtu dëmton reputacionin dhe i ekspozon individët dhe kompanitë ndaj rreziqeve. URI është kundër çdo forme korrupsioni të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përmes palëve të treta. URI do të ndërmarrë masa aktive për të siguruar që asnjë praktikë korrupsioni të mos ndodhë në asnjë prej veprimtarive të tij të biznesit. URI dënon të gjitha format e

ryshfetit dhe korrupsionit. Korrupsioni përkufizohet si abuzim i pushtetit për përfitim personal, dhe praktikat e korrupsionit përfshijnë ryshfetin, mashtrimin, pastrimin e parave, nepotizmin dhe konfliktin e interesit.

5.2 Shmangia e Ryshfetit

Ryshfeti përkufizohet si dhënia ose marrja e diçkaje me vlerë në këmbim të një veprimi ose mosveprimi.

Shembuj të ryshfetit mund të jenë:

- Dhënia e një kontrate një organizate që ka lidhje me një zyrtar publik pa asnjë procedurë të rregullt tenderimi. Zyrtari publik ofron mbështetje politike në këmbim të ryshfetit;
- Dhënia e një dhurate me vlerë të lartë një zyrtari publik për të marrë trajtim të ndryshëm në lidhje me pagesën e taksave;
- Ofrimi i një pune një të afërmi të një zyrtari publik me qëllim që të merret një favor, leje ose miratim nga ai zyrtar publik;
- Dhënia e ditëve pushim zyrtarëve të tenderit për dhënien e tenderit një organizate të caktuar.

Masat për ndalimin e ryshfetit përfshijnë rastet kur shumat të vogla parash u ofrohen zyrtarëve publikë të nivelit të ulët për të përshpejtuar veprimet rutinë për të cilat jemi përgjegjës nga ana ligjore. Pagesa të tilla quhen edhe “pagesa lehtësuese.” Presioni nga faktori “kohë” nuk mund të konsiderohet justifikim për pagesa të tilla.

Mund të lindin situata të caktuara ku një pagesë e tillë duhet të bëhet kur mosbërja e saj do të rezultonte në rrezik të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien fizike të personit. Nëse një pagesë është bërë në rrethana të tilla, ajo duhet të raportohet menjëherë. Ofrimi i dhuratave dhe ftesa e partnerëve të biznesit në evenimente të veçanta mund të ndihmojnë në forcimin e marrëdhënieve të punës. Megjithatë, ato nuk duhet të përdoren për të marrë një shërbim në këmbim, pasi mund të konsiderohen si formë ryshfeti.

5.3 Shmangia e Pastrimit të Parave dhe financimit të terrorizmit

Në asnjë rrethanë URI nuk pranon, lehtëson ose mbështet veprimtari të pastrimit të parave. Pastrimi i parave është procesi i krijimit të pamjes se shumata të mëdha parash të përfituara nga veprimtaria kriminale kanë origjinën nga një burim i ligjshëm.

URI do të respektojë gjithmonë ligjet dhe rregulloret kombëtare për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe kërkesat e organizatave financuese mbi bazë projekti.

5.4 Shmangia e Konflikteve të Interesit

Të gjitha transaksionet e biznesit duhet të bëhen duke marrë në konsideratë interesin më të mirë të URI-t. Konflikti i interesit përfshin rastet kur interesi personal i një punonjësi është kundër ose në konflikt të hapur me interesin e URI-t. Konflikti i interesit mund të jetë faktik ose i perceptuar. Megjithatë, situata të tilla nuk janë gjithmonë të dukshme dhe të qarta. Punonjësit duhet t'i raportojnë menjëherë te drejtuesi i tyre ose përfaqësuesi kontraktor, në

mënyrë që URI të mund t'i menaxhojë, monitorojë, vlerësojë dhe trajtojë siç duhet të gjitha rastet.

5.5 Palët e Treta

URI mund të mbahet përgjegjës për praktikën korruptive të palëve të treta që punojnë në emër të URI-t. Përpara kontraktimit të palëve të treta, drejtuesit duhet të sigurohen që reputacioni, aftësitë dhe përvojat e mëparshme të palëve të treta të jenë të përshtatshme dhe të kënaqshme. URI duhet të ndërmarrë masa të përshtatshme dhe të arsyeshme për të identifikuar dhe vlerësuar integritetin e palëve të treta që punojnë me dhe për URI-n.

URI këmbëngul që palët e treta të respektojnë Kodin e tij të Vlerave dhe Etikës, dhe parakushte të tilla duhet të përfshihen në të gjitha kontratat që URI nënshkruan me palët e treta.

5.6 Lobimi dhe Veprimtaritë Politike

Punonjësit janë të lirë të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në një proces politik. Megjithatë, ata duhet të sigurohen që bindjet dhe veprimtaria e tyre politike personale të mos përfaqësojnë URI-n në asnjë mënyrë.

Për më tepër, punonjësit nuk duhet të përdorin kurrë fondet, asetet dhe burimet e URI-t për të mbështetur një kandidat ose parti politike. Si organizatë, URI do të:

- Nuk përfshihet në veprimtari politike.
- Nuk ofron asnjë kontribut monetar ose në forma të tjera në asnjë kontekst politik;
- Mund të angazhohet në arenat politike, përfshirë lobimin, në debatet për hartimin e politikave për çështjet që URI vlerëson se kanë një interes të ligjshëm për punonjësit e tij dhe komunitetet ku vepron. Veprimtaritë e lobimit janë të rregulluara dhe kryhen vetëm nga persona të autorizuar nga URI.

5.7 Prania në Mediat Sociale

URI kërkon që të gjithë punonjësit të jenë të kujdesshëm me komunikimin me shkrim që mund të publikohet në internet. Nëse punonjësit kanë një prani në internet në forume si blogje, faqe mediash sociale ose faqe personale, ata duhet të sigurohen që mendimet e tyre të jenë qartësisht të vetat dhe të mos lënë përshtypjen se po flasin në emër të URI-t. Punonjësit do të tregojnë kujdes dhe do të shqyrtojnë çdo komunikim përpara publikimit.

Përsa i përket pranisë në internet, URI nuk duhet të dërgojë email ose të publikojë informacione ose materiale konfidenciale që mund të cenojnë reputacionin dhe imazhin e tij.

5.8 Përkushtimi ndaj Mjedisit

Mbrojtja e mjedisit është një nga prioritetet kryesore të URI-t. URI është i vetëdijshëm për detyrimin për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm. Mbrojtja e mjedisit duhet të jetë integrale dhe e ngulitur në proceset e planifikimit, projektimit dhe zhvillimit. URI do ta arrijë këtë përmes përkushtimit, përfshirjes, trajnimit të punonjësve të tij dhe komunikimit të hapur me partnerët e tij.

Përveç kësaj, URI do të:

- Përdorë përpjekje maksimale për të minimizuar efektet negative në mjedis.
- Përpiqet gjithmonë të përdorë burimet natyrore me efikasitet dhe përgjegjësi.
- Monitorojë ndikimin mjedisor të veprimtarive tona në zonat tona të punës.
- T'u përgjigjet ankesave ose pretendimeve për ndikime negative mjedisore me kujdesin dhe vëmendjen më të madhe.

5.9 Keqmenaxhimi Financiar ose i Llojeve të Tjera

Keqmenaxhimi financiar ose çdo formë tjetër e keqmenaxhimit, përfshirë pretendimet, që përfshin personelin, partnerët, organizatat e nënkontraktuara ose konsulentët e URI-t, ose çdo aktor të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me projektet e zbatuara nga URI, do të shkaktojë përfundimin e menjëhershëm të marrëdhënies kontraktore ekzistuese të çdo forme dhe raportimin përkatës sipas procedurave të brendshme të operimit dhe siç kërkohet ligjërisht nga ligji shqiptar, si dhe kërkesave shtesë kontraktore të organizatës financuese.

Një mekanizëm zhdëmtimi do të jetë i përshtatshëm dhe i disponueshëm për ata që preken nga zbatimi i projekteve të URI-t dhe i zbatueshëm për të gjitha veprimtaritë e projektit, të identifikuar si më poshtë:

- Një person/subjekt juridik që preket drejtpërdrejt nga projekti si përfitues
- Banorë/komunitete të interesuar në dhe/ose të prekur nga projekti
- Palët e interesit – persona me interes në projekt
- Një person/subjekt juridik që preket drejtpërdrejt nga projekti përmes marrëveshjeve kontraktore

6. ZBATIMI I KODIT TË VLERAVE DHE ETIKËS

URI siguron që çdo anëtar i organizatës, si dhe çdo kontraktor, nënkontraktor ose partner, të njihet me këtë Kod të Vlerave dhe Etikës, me mekanizmat e ankesave për raportimin e shkeljeve si cenim i çfarëdo vlere apo etike të Kodit, dhe me procedurat disiplinore në fuqi.

Punonjësit, kontraktori, nënkontraktori ose partneri mund të hasin situata ku dyshojnë për shkelje si cenim i çfarëdo vlere apo etike të Kodit. Në raste të tilla, inkurajohen të aksesojnë cilindo nga kanalet e raportimit siç parashikohet në Politikën e Informimit të Brendshëm (Whistleblowing) të organizatës, dhe siç parashikohet në faqen e internetit të organizatës: www.uri.org.al, për të:

Çdo anëtar i organizatës, si dhe çdo kontraktor, nënkontraktor ose partner, bashkëpunon sipas detyrës së tij më të mirë si pjesë e një hetimi për shkelje ose procesi auditimi të nisur brenda organizatës ose nga autoritetet kombëtare.

Punonjësit ndalohen të shkatërrojnë të dhëna përpara ose gjatë procesit të hetimit ose auditimit të nisur brenda organizatës ose nga autoritetet kombëtare.

Punonjësit, kontraktori, nënkontraktori ose partneri marrin pjesë në trajnime dhe mbahen të informuar për standardet dhe politikat e organizatës.

Në nivel drejtimi, URI diskuton në mënyrë proaktive çështjet etike brenda organizatës dhe nxit një mjedis pune ku punonjësit ndihen të sigurt dhe të inkurajuar të diskutojnë dhe të raportojnë shkelje të mundshme të këtij Kodi të Vlerave dhe Etikës.